

VENDIM
Nr. 12, datë 29.1.2016

MBI ANKANDET E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT NË KUFIRIN ME KOSOVËN

Në mbështetje të neneve 16, 18 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 111, 112 dhe 127 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 3, pika 1, germa “d”; dhe 16, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.1.2016, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, pasi shqyrtoi kërkesën e “OST” sh.a. në lidhje me alokimin e kapaciteteve në kufirin me Kosovën,

konstatoi se:

- Rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) nuk mund të aplikohen me vende kufitare të cilat nuk i kanë kapacitetet të alokuara në SEE CAO.

- Kufiri Shqipëri–Kosovë nuk është përfshirë në ankandin vjetor të kapaciteteve të interkonjeksionit të zhvilluar nga SEE CAO, për shkak të paqartësisë së funksionimit të KOSTT-së, si zonë e pavarur rregulluese e njohur nga ana e ENTSO-ve. Kjo gjë evidentohet edhe në faqen zyrtare të SEE CAO.

- Me shkresën nr. prot. 587/1, të datës 29.1.2016, “OST” sh.a. ka depozituar në Entin Rregullator të Energjisë, kërkesën për miratimin nga Bordi i Anëtarëve të ERE-s, të një rregulli përjashtues, i cili të paraprijë e të shmangë problematikat në zhvillimin e ankandëve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën, që mund të zhvillohen edhe në të ardhmen nëse *status quo* e Kosovës nuk ndryshon.

- ERE ndodhet në kushtet e detyrimit për t’u shprehur me një vendim rregullues, në lidhje me rrethanat e parashikuara në problematikat e parashtruara nga “OST” sh.a. dhe të njohura publikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare të SEE CAO, rrethana, të cilat nëse pushojnë se ekzistuari, shterojnë edhe fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën, “OST” sh.a. do të zbatojë vendimin nr. 140, datë 22.11.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, i ndryshuar.

2. Ky vendim shteron fuqinë e tij juridike me ndryshimin e rrethanave që çuan në miratimin e tij.

3. “OST” sh.a. ka detyrimin për njoftimin e ndryshimit të këtyre rrethanave në ERE.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për të njoftuar të licencuarin “OST” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1.1.2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti